



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 388, Datë 28.12.2023

MBI

ZBATIMIN E DETYRIMIT PËR MBAJTJEN E LLOGARIVE TË NDARA

Në mbështetje të neneve 16, 22, gërma “j” dhe 35, pika 1 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; pikës 6.2, gërma “c” të “Kushteve të Licencës për Veprimtarinë e Prodhimit të Energjisë Elektrike”; pikës 4.4 të “Kushteve të Licencës për Veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike”, si dhe pikës 7.7 të “Kushteve të Licencës për Veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike”, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2549 prot., datë 22.12.2023, të Grupit të Punës, “Mbi monitorimin e të licencuarve në veprimtarinë e prodhimit, furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike, në lidhje me mbajtjen e llogarive të ndara”,

**Konstatoi se:**

- Me Urdhrin e Kryetarit të ERE-s është ngritur Grupi i Punës, për monitorimin e shoqërive të licencuara në veprimtarinë e prodhimit, tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike, me objekt:
  - mbajtja e llogarive të ndara
  - struktura organizative aktuale e shoqërisë, e shoqëruar me informacionin përkatës mbi strukturën/stafin e dedikuar për veprimtarinë e licencuar.
- Në zbatim të detyrës së ngarkuar, u janë dërguar shkresat subjekteve të licencuara duke u kërkuar që në përmbushje të objektit të këtij monitorimi të depozitojnë në ERE dokumentacionin si vijon:
  - Pasqyrat financiare të shoqërisë të plota (së bashku me shënimet shpjeguese).
  - Strukturën organizative aktuale të shoqërisë, të shoqëruar me informacionin përkatës mbi strukturën/stafin e dedikuar për veprimtarinë e licencuar.
- Pas shqyrtimit të informacionit/dokumentacionit të depozituar në ERE nga të licencuarit që iu përgjigjën këtij monitorimi, në zbatim të përcaktimeve të nenit 13, pikës 4 të “Rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 199, datë 27.11.2020, të licencuarve të monitoruar janë listuar në shkresat (e datës 08.02.2023, 09.02.2023 dhe 14.02.2023, me gjetjet përkatëse të

këtij monitorimi, duke i kërkuar që të depozitohen në ERE qëndrimet apo kundërshtimet mbi sa konstatuar nga Grupi i Punës, në rast se do të kishin të tilla.

- Për sa i përket objektit të parë të monitorimit, që lidhet me: *mbajtjen e llogarive të ndara*, me qëllim realizimin e një raporti monitorimi sa më gjithëpërfshirës, për të licencuarit që nuk iu përgjigjën kërkesave të monitorimit, Grupi i Punës mori në shqyrtim raportet financiare të të licencuarve të periudhës kontabël 01.01.2021 - 31.12.2021, të aksesuara nga faqja elektronike e Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), si dhe raportet financiare të vitit 2021 të depozituara në kuadër të përmbushjes së kushteve të licencimit.
- Bazuar në nenin 22, gërma “j”, nenin 35, pika 1, të ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, shoqëritë që operojnë në veprimtaritë e prodhimit, furnizimit ose të tregtimit të energjisë elektrike, kanë detyrimin e ndarjes efektive të llogarive për secilën nga veprimtaritë e licencuara, si dhe për çdo aktivitet tjetër që nuk lidhet me sektorin e energjisë elektrike, me qëllim shmangien e ndër subvencionimit dhe cenimit të konkurrencës.
- Në kuptim të sa më sipër, secila nga veprimtaritë e licencuara aktive, si dhe çdo aktivitet tjetër që nuk lidhet me sektorin e energjisë elektrike, duhet të paraqitet në llogari të veçanta, me qëllim shmangien e ndër subvencionimit.
- Po ashtu, evidentojmë se: Për t’ju ardhur në ndihmë të licencuarve, ERE ka vendosur në dispozicion të tyre “Manualin e llogarive për qëllime të rregullimit të shoqërive të licencuara në sektorin e energjisë elektrike”, i cili është një udhëzues i detajuar i standardeve të njehsuara të llogarive. Ky manual ofron rregullat për mbajtjen e llogarive të ndara nga shoqëritë e licencuara në sektorin e energjisë elektrike
- Bazuar në gjetjet e këtij monitorimi, por dhe sa parashikuar nga licencat përkatëse në kuadër të korrigjimit të shkeljes së këtij kushti të licencës, ka rezultuar se nuk zbatohen detyrimin, që rrjedh nga ligji i sektori dhe licenca përkatëse, për të mbajtur llogari të ndara, t’i jepet një mundësi për të korrigjuar këtë shkelje, duke i lënë detyrë që në pasqyrat financiare të vitit 2023, të pasqyrohen dhe llogaritë e ndara për secilën veprimtari të licencuar për subjekte si vijon:
  - “EUROBIZNES” sh.p.k.
  - “GEGA – G” sh.p.k.
  - “AFRIM K” sh.p.k.
  - “AGE Sunpower” sh.p.k.
  - “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a.
  - “INFO Telecom” sh.p.k.
  - “ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA” sh.p.k.
- Për sa i përket objektit të dytë të monitorimit, që lidhet me *strukturën organizative të të licencuarve*, gjetjet e këtij monitorimi vlerësohen informuese i përket identifikimit të stafeve përkatëse të të licencuarve referuar veprimtarive të licencuara.
- Referuar gjetjeve të këtij monitorimi, si për sa i përket mënyrës së mbajtjes së llogarive të ndara, ashtu dhe për sa i përket stafit organizativ, vlerësohet mundësia e konsultimeve me subjektet, duke organizuar seanca dëgjimore apo takime me përfaqësues të ERE-s dhe të të licencuar, ku do të jepen dhe orientimet përkatëse në lidhje me zbatimin e detyrimit për të mbajtur llogari të ndara e po ashtu mbi përbërjen e stafit që duhet të ketë një i licencuar, e konstatuar kjo përgjatë korrespondencave që ERE ka zhvilluar me ta. Për sa më sipërvlerësohen orientimet në vijim, me qëllim të kuptuarit drejtë dhe për mbarëvajtjen e punës mes ERE-s dhe të licencuarve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Brenda datës 31.03.2024, licencuarit si vijon duhet të zbatojnë detyrimin për mbajtjen e llogarive të ndara për secilën prej veprimtarive të licencuara:
  - a) “EUROBIZNES” sh.p.k.
  - b) “GEGA – G” sh.p.k.
  - c) “AFRIM K” sh.p.k.
  - d) “AGE Sunpower” sh.p.k.
  - e) “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a.
  - f) “INFO Telecom” sh.p.k.
  - g) “ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA” sh.p.k.
2. Përmbushja e këtij detyrimi duhet të pasqyrohet në pasqyrat financiare të vitit 2023 që do të depozitohen në ERE brenda afateve të përcaktuara në kushtet përkatëse të licencave.
3. Grupi i punës të njoftojë të licencuarit të njoftojë të licencuarit “EUROBIZNES” sh.p.k.; “GEGA – G” sh.p.k.; “AFRIM K” sh.p.k.; “AGE Sunpower” sh.p.k.; “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a.; “INFO Telecom” sh.p.k., “ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.
4. Grupi i punës duhet të raportojë pranë Bordit të EREs brenda datës 31.07.2024, mbi zbatimin e detyrave sipas këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**

**KRYETARE NË DETYRË**  
**Erjola SADUSHI**